

LIGJ
Nr.7542, datë 18.12.1991

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.4976, DATË 29.6.1972 "PËR PENSIONET E ANËTARËVE TË KOOPERATIVAVE BUJQËSORE"

Në bazë të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.4976, datë 29.6.1972 "Për pensjonet e anëtarëve të kooperativave bujqësore", pas nenit 29, shtohet neni 29/a me këtë përmbajtje:

"Nuk konsiderohet ndërprerje në punë, për efekt të zbatimit të neneve 3/a, 6, 10, 13 dhe 14 të këtij ligji, periudha nga data e shpërbërjes së kooperativës bujqësore deri në datën që mbi bujkun privat shtrihet sigurimi i detyruar".

Neni 2

Pas neni 3/a shtohet neni 3/b me këtë përmbajtje:

"Anëtari i kooperativës bujqësore dhe bujku privat marrin një ndihmë të njëhershme prej 200 lekësh për çdo fëmijë që lind i gjallë.

Në rast vdekjeje të anëtarit të kooperativës bujqësore, bujkut privat, pensionistit ose të një anëtari të familjes që ka qenë efektivist në ngarkim, të afërmit marrin një ndihmë në të holla prej 300 lekësh për shpenzime varrimi".

Neni 3

Paragrafi i dytë i nenit 9/b ndryshohet si vijon:

"Kjo ndihmë përballohet nga buxheti i shtetit".

Neni 4

Në nenin 31 shtohen dy praragrafë me këtë përmbajtje:

"Dispozitat e këtij ligji shtrihen edhe mbi bujkun privat dhe në persona të tjerë, që me dispozita të Këshillit të Ministrave njësohen me ta, sigurimi i të cilëve është i detyrueshëm.

Këshilli i Ministrave cakton masën dhe kriteret e derdhjes së kontributit e të llogaritjes së sigurimeve e të pensioneve".

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.103, datë 25.12.1991 të Presidentit të Republikës së shqipërisë, Ramiz Alia.